



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZLAnr.2/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi anëtarë e Adnan Konushevi, anëtarë dhe me zyrtaren e lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Jedistvena Goranska Partije (JGP), me seli në Dragash, kundër Komisionit Komunal Zgjedhor-(KKZ), me seli në Dragash, në seancën e panelit të mbajtur me 24.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si i palejuar apeli i Jedistvena Goranska Partije (JGP), me seli në Dragash.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga përfaqësuesi i Jedistvena Goranska Partije (JGP), kundër Komisionit Komunal Zgjedhor-(KKZ), me seli në Dragash, me të cilin pretendon se është kundërshtuar përfaqësimi i anëtarëve të tyre në KKZ nga ana e koordinatorit të po të njëjtës Komunë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datën 21.07.2017 kërkoi nga parashtruesi i ankesës që deri me datën 24.07.2017 ta plotësoj ankesën me numër ZLAnr. 2/2017 të datës 20.07.2017, gjegjësisht që ta specifikoj saktësisht se ndaj cilit vendim të KQZ ka ushtruar ankesë, si dhe të precizoj kërkesën e tyre, pasi që një specifikim i tillë nuk është potencuar në ankesë. Me të njëjtin njoftim PZAP-i, i ka bërë të ditur parashtruesin të apelit se do të konsiderohet i tërhequr apeli po që se nuk i kthehet PZAP-it deri më datën 24.07.2017 në ora 09:00.

Pas kërkesës së bërë nga PZAP-i, parashtruesi i apelit ofroi përgjigjen e kërkuar lidhur me plotësimin e apelit në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi bazën juridike për paraqitjen e apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Nga ankesa e parashtruar dhe plotësimi saj i bërë sipas kërkesës së PZAP-së nga ky subjekt politik, del se Jedistvena Goranska Partije (JGP), me seli në Komunën e Dragashit pretendon se është kundërshtuar përfaqësimi i anëtarëve të këtij subjekti në KKZ. Paneli ka shqyrtuar ankesën, pretendimet në të si dhe ato që janë ofruar nga ana e subjektit ankues në plotësimin e ankesës dhe ka gjetur se apeli i bërë i është pa lejuar.

Paneli vlerëson se në rastin konkret parashtruesi i apelit nuk ka bazë ligjore për ankimin e nominimeve nga ana e koordinatorit të KKZ-së. Me dispozitën ligjore të nenit 122 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është përcaktuar qartë se në cilat raste mund të ankimohen vendimet KQZ-së. Paneli gjen se natyra ankimit të parashtruar nuk hyn në shkaqet e parapara me nenin 122 të LZP. Me nenin 63 par. 6, të LZP-së është përcaktuar se nuk është i lejuar ankimimi ndaj të gjitha vendimeve të KQZ-së, përveç atyre të parapara me ligj.

Për arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLA nr. 2/2017 më datën 24.07.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.